



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 5730/ Prot. Datë 22.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

Nr. 6153 Prot. Datë 24.7.2026

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 12, datë 22.07.2026

PËR

ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË
MATURËS SHTETËRORE 2026 DHE MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2026

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 51 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J M Ë:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2026, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 24 gusht 2026 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 27 gusht 2026 |
| c) Matematikë | 31 gusht 2026 |
| ç) Provim me zgjedhje | 3 shtator 2026 |

2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|---|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 24 gusht 2026 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 27 gusht 2026 |
| c) Matematikë | 31 gusht 2026 |
| ç) Provim i teorisë profesionale të integruar | 3 shtator 2026 |

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2026 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2026 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë:
 - a) Fillojnë në orën 10:00;
 - b) Zgjasin 2 orë e 30 minuta;
 - c) Testet hartohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2026 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë, marrin pjesë:
 - a) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2026 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i parë.
 - b) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2025-2026 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 7 gusht 2026.
 - c) Maturantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2026, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale, në vitin 2026, sesioni i parë.
 - ç) Maturantët/kandidatët që kanë kryer njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale, 2026.
6. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën që u cakton zyra vendore e arsimit parauniversitar (ZVAP).
7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë Formularin ALZ, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale, 2026 nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë.
8. Maturantët/kandidatët me aftësi të kufizuara do të zhvillojnë provimet e Maturës Shtetërore bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 49 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 31 dhe 31/1 të Rregullores “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 661, datë 01.12.2023, të ndryshuar.
9. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar dërgon zyrtarisht në ZVAP, listën e maturantëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2026 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë, deri më datë 9 gusht 2026. Drejtori i ZVAP, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 10 gusht 2026.
10. Provimet të zhvillohen të përqendruara. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) përcakton qendrat e provimeve duke u bazuar në numrin e maturantëve dhe në largësinë nga qendra e provimit.
11. ZVAP-et dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maturantëve për qendrën, datat dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2026 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë.
12. Drejtori i AKAP, brenda datës 11 gusht 2026 të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe MA, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës

Shtetërore 2026, sesioni i dytë dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2026 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë.

13. Monitorimi i procesit të Maturës Shtetërore 2026 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MA-it dhe të institucioneve të varësisë.
14. Shpenzimet e përfaqësuesve të MA-it për monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2026 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2026, sesioni i dytë, të mbulohen nga institucionet ku janë të punësuar.
15. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI



MINISTËR

DELINA IBRAHIMAJ

